



Datë/a:	13.12.2018
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: "Eing Com"
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 11.12.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "Eing Com" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha" me Nr. të Prok: 616 18 120 521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eing Com", të dt. 11.12.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha" me Nr. të Prok: 616 17 120 521 kundër Njoftimit mbi vendimin të AK -së, të datës 06.12.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me propozimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha", me Nr. 616 18 120 521 dhe mbështet njoftimin mbi vendimin e AK kontratës lidhur me këtë aktivitet.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 18.10.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: **Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha**, me Nr. **616 18 120 521**.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 14.11.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Janë pranuar 4 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 06.12.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin e vendimit së bashku me letrat standarde pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje. Me datë 07.12.2018 Operatorit Ekonomik "Eing Com", iu ka lejuar qasja në dokumentacion të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë lidhur me këtë tender.

Ndërtimi Parku i Diellit tek kompleksi i Banesave të Bardha me Nr. **616 18 120 521** kundër Njoftimit të vendimit së bashku me letra standarde të aktivitetit të prokurimit të AK – së, të datës 06.12.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 11.12.2018 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, në të cilin pretendon:

A).Pretendimi 1: Traktor është frezim me të gjitha pajisjet adekuate për të cilin është kërkuar që të dëshmohet me deklarate doganore, libreza e qarkullimit, marrveshjet për blerjet mbi rregullsinë teknike dhe regjistrimin e traktorit, ashtu siç kërkohet në LIGJIN NR.05/L-132 PER AUTOMJETE dhe UDHEZIM AMINISTRATIV(MPB) NR. 01/2018, PER REGJISTRIMIN E MJETEVE të lëshuara nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe ministrisë së punëve të brendshme.

B) Pretendimi 2: në dosjen tenderit pika 9.1&9.2 kapaciteti teknik dhe profesional në pozicionin 2 kërkohet: "2.Tsafi i nevojshëm: Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv-tri vite përvojë pune, 1 inxhinier i diplomuar i arkitekturës-tri vite përvojë pune, 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi gjeodezi/bechelor-tri vite përvojë pune, 1 teknik i bujqësisë/ekologjisë.

*Për stafin teknik i bujqësisë, ekologjisë OE i rekomanduar për kontrate ka propozuar z. Jeton Halit Sylaj, me te cilin ka marrëveshje me date 14.11.2018. ne fillim te CV se tij shkruan emri i tjetër personi Berat Hasanaj. Bashkëpunimi me Jeton Halit Sylaj është bere me date 14.11.2018, ndërsa ne CV janë prezantuar pune qe janë kryer ne vitin 2014. P.SH. Nderimi i rrugëve me kabëza betoni-faza e trete 2016
 Ndërtimi i rrugës Barileve-Besi viti 2015
 Ndërtimi i trotuarit me ndriçim solar ne Dardhishte viti 2014
 Pra te gjitha projektet e paraqitura ne CV janë te përfunduara para se OE EKO Group shpk me pas marrëveshje me te Jeton Sylaj për me tepër Jeton Sylaj ka qene edhe i pa diplomuar ne atë kohe.*

I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari nenin 6 (Parimi i Efikasitetit dhe Ekonomizimit) dhe nenin 7 (Parimi i Barazisë / jo diskriminimit) të Ligjit për Prokurimin Publik të konsoliduar me Nr. 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues hedhe poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se KK Prishtina ka vlerësuar ofertat ne përputhje me LPP-ne.

*Pretendimi 1: Pretendimi 1: Traktor është frezim me te gjitha pajisjet adekuate për te cilin është kërkuar qe te dëshmohet me deklarate doganore, libreza e qarkullimit, marrëveshjet për blerjet mbi rregullsinë teknike dhe regjistrimin e traktorit, ashtu siç kërkohet ne **LIGJIN NR.05/L-132 PER AUTOMJETE dhe UDHEZIM AMINISTRATIV(MPB) NR. 01/2018, PER REGJISTRIMIN E MJETEVE te lëshuara nga ana e Kuvendit te Kosovës dhe ministrisë se punëve te brendshme.***

AK hedh poshtë këtë pretendim sepse vlerësimi është kryer ne përputhje me kërkesat e DT.

Kërkesa	Dëshmia
Paisjet e nevojshme: 1 eskavator 3 kamiona 1 cilinder 1 traktor per frezim me te gjitha paisjet adekuate	Dëshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira) te mjeteve, Deklaratat unike doganore - Librezat e qarkullimit

OE ka sjell dëshmi valide DUD për pajisjen traktor, konform kërkesave të dosjes së tenderit, kjo dëshmi është pranuar pasi që kërkesa ka qene qe të sillen ndonjë dëshmi e përcaktuar në dosje.

Pretendimi 2:) Pretendimi 2: në dosjen e tenderit pika 9.1&9.2 kapaciteti teknik dhe profesional në pozicionin 2 kërkohet: "2.Stafi i nevojshëm: Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtim konstruktiv-tri vite përvojë pune, 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi arkitekturës-tri vite përvojë pune, 1 inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi gjeodezi/bechelori-tri vite përvojë pune, 1 teknik i bujqësisë/ekologjisë. Per stafin teknik i bujqësisë, ekologjisë OE i rekomanduar për kontrate ka propozuar z. Jeton Halit Sylaj, me të cilin ka marrëveshje me datë 14.11.2018. në fillim të CV së tij shkruan emri i tjetër personi Berat Hasanaj. Bashkëpunimi me Jeton Halit Sylaj është bere me datë 14.11.2018, ndërsa në CV janë prezantuar pune që janë kryer në vitin 2014. P.SH. Nderimi i rrugëve me kubeza betoni-faza e trete 2016
Ndërtimi i rrugës Barileve-Besi viti 2015
Ndërtimi i trotuarit me ndriçim solar në Dardhishte viti 2014
Pra të gjitha projektet e paraqitura në CV janë të përfunduara para se OE EKO Group shpk me pas marrëveshje me të Jeton Sylaj për me tepër Jeton Sylaj ka qene edhe i pa diplomuar në atë kohë.

Komisioni vlerësues ka vlerësuar sipas kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit. Në CV është një gabim në fillim të saj, duke qene e shkruar një emër tjetër por që në dy vende tjera brenda CV është cekur emri i Jeton Halit Sylaj. AK këtë e ka konsideruar si gabim teknik.

Kërkesa	Dëshmia
Stafi i nevojshëm: 1 inxhinier i diplomuar i ndertimtarise drejtimi konstruktiv- tri vite pervoje pune 1 inxhinier i diplomuar i arkitektures - tri vite pervoje pune 1 inxhinier i diplomuar i ndertimtarise drejtimi gjeodezi/bechelori - tri vite pervoje pune 1 teknik i bujqesise/ekologjise	CV-a; Diploma; Kontrata e punës me punëdhënësin valide ose marreveshje për angazhim.

Ashtu siç është cekur ne Pretendimin nr.2 te OE po ashtu edhe ne dosje, nuk ka pasur kërkesë qe te dëshmohej përvoja e punës për stafin teknik i bujqësisë, ekologjisë.

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe duke zbatuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik, Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

